

Mr. Ali Bardhi
Dr. Behlul Kanaqi

TUZI PËRGJATË SHEKUJVE OSMANË

Zona e Tuzit (ashtu si i gjithë rajoni përreth) dhe treva e Ulqinit, ku kemi bërë studime, bart vlera të jashtëzakonshme të një trashëgimie kulturore autoktone. E gjithë kjo hapësirë, ku rrjedhimisht bën pjesë edhe Tuzi, përgjatë historisë, i përket trashëgimisë kulturore autoktone të fisit ilir të labeatëve. Në këtë rajon janë identifikuar edhe gjetjet e kulturës materiale të periudhave të mesjetës, kohës së re dhe asaj bashkëkohore, gjë që dëshmon për vazhdimësinë e jetës në trevën e komunës së Tuzit (Malësi) që nga parahistoria.

Nga literatura shohim se në shekullin XIV, Tuzi na paraqitet si emër fisi dhe vendbanimi. Për të parën herë, Tuzi, si një ngulim i vjetër që ndodhet karshi Podgoricës, i quajtur ndryshe edhe “Katuni” (Bashkësia e barinjve)¹, përmendet në vitin 1330, në një kristobulë të Manastirit të Deçanit, kryetar i të cilit ishte Llesh Tuzi.² Megjithëse Tuzi në dokumentet e shkruara për të parën herë ndeshet në vitin 1330, këto troje kanë qenë të banuara nga banorët autoktonë ilirë qindra vite para toponimit “*Tuz*, *Tussis*” apo ndonjëherë “*Tushena (Tuscena)*”.³ Kurse në vitet 1416-1417, Tuzin e shohim të ketë qenë një fshat që numëronte gjithsej 150 shtëpi.⁴

Periudha në të cilën rajoni dhe zona e Tuzit filluan që të njihen me osmanët, janë vitet 1385-1387, 1392, 1405 dhe 1410, kur sundimtarët Balshaj ranë nën vasalitetin e osmanëve, periudhë gjatë së cilës Balshajt ishin edhe në përballje me Uroshin I dhe venedikasit për pavarësi. Por përfundimisht, kalaja e parë në afërsi të Tuzit, që u bë pjesë e Perandorisë Osmane, ishte Meduni (Meteoni) (1455). Në vitin 1474, edhe Podgorica bie nën sundimin osman. Më pas, në vitin 1478, edhe Kalaja e Zhabjakut bie nën osmanët.⁵

1 Në të folmen e shqipës në këto anë, fjala “katun” përdoret si sinonim i fjalës “fshat”.

2 Kostantin Jireček, *Nga Shkodra gjër në Vlorë nëpër Shqipërinë Mesjetare*, f. 32.

3 Ndue Bacaj, *Tuzi në kapërcyejt e shekujve*. <https://www.albdreams.net/>

4 Injac Zamputi, *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417*, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë, 1974, f. 53.

5 Bajro Agović, *Džamije u Crnoj Gori*, Almanah, Podgorica, 2001, f. 65, 68, 74, 86, 111.

Ndërsa për vendbanimin e Tuzit, i cili ndodhej në afërsi të bregut të liqenit të Shkodrës dhe ndërmjet hapësirës së Kalasë së Zhabjakut dhe Drishtit, shohim se në vitin 1478 ranë njëherësh nën sundimin osman, çka tregon se ky vendbanim u përfshi në Perandorinë Osmane që nga periudha e Sulltan Mehmetit II.⁶ Duhet cekur se nga burimet historiografike nuk shohim që të jetë zhvilluar ndonjë betejë në Tuz, pasi mendojmë se ai nuk kishte ndonjë fortifikatë dhe ishte vetëm një fshat.

Sipas regjistrit (defter) osman të vitit 1485 vërejmë se përveç emërtimit të fshatit Tuz, i cili varej nga Zhablaku, krahina e Podgoricës, dhe që ishte timar i Hasan Arnautit, atë e ndeshim të shënuar edhe si mbiemër të banorëve. Po të analizojmë më hollësisht këtë regjistrë do të shohim se fshati Tuz, për të cilin po flasim, numëronte njëzet e katër shtëpi-hane të krishtera, gjashtë beqarë dhe të ardhurat së bashku me ispenxhen, arrinin në tri mijë akçe dhe asnjë shtëpi myslimane e regjistruar. Sipas regjistrit në fjalë, vëllazëria e Tuzëve gjendej e vendosur edhe në disa vendbanime të tjera që ruanin emrin e fisit të Tuzit nga rridhnin, si: fshati Damniç-Tuz, Bgur-Tuz, Koqik-Tuz, Istulush-Tuz, Petroschan-Tuz etj. Ndërsa në regjistrin osman të vitit 1530 shohim të shënuar fshatin Tuz edhe vendbanimin (mezra) Tuz, i cili varej nga Podgorica, sanxhaku i Shkodrës, dhe numëronte nëntëdhjetë e pesë hane-shtëpi të krishtera dhe myslimane, si dhe shtatë beqarë.⁷ Në regjistrin osman të vitit 1582 fshati Tuz, për të cilin bëjmë fjalë, tashmë i numëronte gjashtëmbëdhjetë shtëpi myslimane, një benak, gjashtë beqarë, si edhe njëqind e tridhjetë e tre shtëpi e bashkina të krishtera dhe njëzet e nëntë beqarë.⁸

6 Kronistët osmanë kur flasin për zaptimin e Kalasë së Shkodrës (Arnaut Iskenderiyesi), pohojnë se ajo i ka rezistuar ushtrisë osmane, falë tri kalave përreth saj (Kalaja e Zhablakut, e Drishtit dhe e Lezhës), të cilat e përforconin me ndihma atë. Secila prej tyre ishte e pashoqe dhe e njohur nga të gjithë për fortësinë. Ato janë ruajtëset e Shkodrës. Kështu në vitin 1478, nën komandën e Bejlerbeut të Rumelisë, Davud Pashës, pa ndonjë rezistencë ra Kalaja e Zhabjakut. Menjëherë pas saj, nën komandën e Bejlerbeut të Anadollit, Sylejman Pashës dhe Davud Pashës, ra edhe ajo e Drishtit. Më pas bie edhe Kalaja e Lezhës dhe në fund, më 1479-n, bie edhe Kalaja e Shkodrës. Kronisti osman Kemal Paşazade pohon se kjo krahinë konsiderohet si pjesë e vilajetit të shqiptarëve, por për arsye se ndodhet pranë detit, ka mbetur nën kthetrat e Venedikut. Zhabjaku përmendet në mes viteve 1403-1435 si kështjellë e Llesh Cërnojeviqit. Në momentet e rënies së Kalasë së Zhabjakut nën osmanët, në krye të kësaj kalaje ishte Ivan Cërnojeviqi, vasal i Venedikut. Këtë kala pasi venedikasit e marrin nga Balshajt, vetë Shkodra do ta mbajë nën sundimin e saj deri në vitin 1479. (Shih Selami Pulaha, *Lufia shqiptaro-turke 1370-1530, Burime osmane*, Helga'S Secret, Tiranë, 2017, f. 111-113, 115-124, 159-165, 200-204, 239-240, 259, 271-273, 282-283; Bajro Agović, *Po aty*, Podgorica, 2001, f. 110).

7 BOA, TD, 367 *numaralı Muhâsebe-I Vilâyet-i Rûm-îli Defteri (937/1530)*, f. 319.

8 Selami Pulaha, *Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, f. 152-155, 397; Përparime Huta, *Fshati në Sanxhakun e Shkodrës (XV-XVI)*, Akademia e Shkencave të Republikës

Në vitin 1614, për Tuzin shënohen vetëm tridhjetë shtëpi me shtatëdhjetë burra të aftë për armë. Në një dokument të vitit 1621, Tuzi së bashku me Hotin përmenden si qyteza, ndërkohë që Gruda nuk përmendet fare. Ndërkohë që në një hartë të V. Coronellit, të vitit 1690, Tuzi (Tuscena) dhe Dinoshë (Dinosci) përmenden si të vetme, duke mos u shënuar fare emri i Grudës. Porse nga kronikat e vitit 1671 dhe 1688 numri i shtëpive të Tuzit mbeti thuhet se njëjtë me vitin 1614 (30 shtëpi) dhe shënohet si fshat që i mbështetej Traboinit të Hotit⁹, çka tregon se përgjatë këtyre viteve, statusi i tij mbetet i paqartë për ne dhe se duhen bërë hulumtime më tej.

Ndërkohë që viti 1478 shënon rënien e të gjitha kalave përreth liqenit të Shkodrës, dhe ndërmjet kësaj hapësire ndodhej edhe fshati Tuz. Mendojmë se ai nuk përbënte ndonjë rëndësi strategjike për osmanët për t'u përqendruar në të. Prandaj kjo mund të ketë qenë edhe njëra prej arsyeve kryesore që popullsia e tij nuk u rrit për shumë shekuj, por mbeti në statusin e fshatit, i cili braktisej vazhdimisht nga banorët e tij. Ata zhvendoseshin në qendrat më të rëndësishme zhvillimore të kohës në afërsi të tij, si në Zhablak, Podgoricë, Shpuzë, Shkodër e me radhë.

Siç u pohua edhe më lart, deri në fund të shekullit XIX, Tuzi mbeti në statusin e mëparshëm të fshatit. Në fillim ai varej nga Zhabjaku së bashku me Grudën, kurse më vonë nga krahina (nahija) e Hotit e më pas nga vetë krahina e Grudës, kazaja e Podgoricës. Sipas konsullit francez në Shkodër, Hyacinthe Hecquard, në vitin 1851, Gruda dhe Tuzi kishin një bajrak që shtrihej nga fshati Dinoshë, deri në fisin e Triepshit, kufizohej nga Fundna e Kuçit dhe lumi Cem e ndante prej fisit të Hotit. Dhjetë vite më pas, sipas relacionit të Ahmet Xhevdet Pashës (1861) përmendet krahina e Grudës, Hotit si edhe të tjera, porse Tuzin nuk e shohim të jetë përmendur fare. Kjo na bën të kuptojmë se Tuzi akoma ruante statusin e mëparshëm të tij, duke qenë pjesë e krahinës së Grudës. Mirëpo nga të dhënat që na jep inspektori i arsimit, Daut efendi Boriçi, në ditarin e tij (1870-1877) për Malësinë e Madhe, shohim se edhe Tuzi, sikurse Gruda, ka pasur bajraktarin (alemdarin), i cili ka qenë Tafil Kurti, gurvarrin e të cilit e kemi gjetur në varrezën e Xhamisë së Vjetër të Nizamëve. Kurse

së Shqipërisë, Tiranë, 1990, f. 154.

9 Vincenzo Coronelli, *Map of Montenegro-1690*; Ndue Bacaj, *Po aty*; Injac Zamputi, Selami Pulaha, *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, Vëllimi III, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (RPSSH), Shtypshkronja e Re, Tiranë, 1989, f. 388.

bajraktari i Grudës ka qenë Ismail Martini.¹⁰ Sipas salnames së vilajetit të Shkodrës, në vitin 1892, shohim se Malësia e Grudës si një njësi zotëronte dy bajraqe¹¹, ku njëri ka qenë në Dinoshë dhe tjetri në Tuz.¹²

Edhe pse në Malësi, në popull, akoma ruhej rendi i vjetër duke respektuar bajraqet e veta deri në vitin 1912, shohim se pas aneksimit të kazasë së Podgoricës nga Mali i Zi në vitin 1878, do të pasojë mënyra e re e administrimit osman të këtyre zonave. Malësitë, me bajraqet e veta, si Gruda (Dinosha e Tuzi), Traboini etj., që më parë ishin pjesë e kazasë së Podgoricës, mbetën nën territorin e vilajetit të Shkodrës, gjegjësisht në Perandorinë Osmane. Për rrjedhojë, do të kemi edhe ndryshimin e statusit të Tuzit, fakt të cilit e shohim nga dy dosje të Arkivit Osman të Presidencës, në Stamboll, ku tregohet se më 29 mars 1879, u formua kajmekami (kazaja) i Grudës, me qendër Tuzin, por që, për shkak të rëndësisë dhe ndikimit që kishte si qendër në zonat fushore, më 31 korrik 1879, nga emri i kazasë së Grudës e mori atë të Tuzit, dhe në krye të saj u emërua një kajmekam. (BOA, *İ.ŞD.* 45/2405; *İ.DH.* 789/64127. Shih në shtojcë faksimilen nr. IX).

Mbi bazën e dokumenteve arkivore dhe salnameve, kemi mundur të nxjerrim emrat e kajmekamëve/kryetarëve të kazasë së Tuzit nga krijimi e deri në aneksimin e tij nga Mali i Zi (1879-1912):

- Në vitin 1879, si kajmekam i parë i Grudës-Tuzit, emërohet Haxhi Osman Pasha (BOA, *İ.DH.* 789/64127).
- Në vitin 1881, Halil efendi Podgoričani, i cili qe shpërngulur në Shkodër më përpara, emërohet në detyrën e kajmekamit të Tuzit (BOA, *Y.A...RES.* 11/61; *DH.MKT.* 1338/22).
- Në nëntorin e vitit 1882, si kajmekam të Tuzit shohim Halil Shahab Beun (BOA, *İ..DH.* 869/69494).
- Më pas, në vitin 1884, në këtë post shohim të ketë qenë Shaban Beu (BOA, *Y.A...RES.* 19/47; *İ..DH.* 911/72392; *İ..HR.* 295/18643).
- Pasi kajmekami i Tuzit Shaban Beu shkarkohet, në vend tij vjen

10 Ali Bardhi, *Müfettiş Davut Borici`nin Günlüğünde İşkodra Vilayeti`nde Eğitim 1870-1877*, f. 305; Pas vitit 1878, bajraku i Grudës me qendër Dinoshën përfshinte fshatrat Milesh, Vllanë, Vrane. Kurse bajraku i Tuzit përfshinte qendrën e Tuzit. Shih Kahreman Ulqini, *Bajraku në organizimin e vjetër shoqëror (fundi i shek. XVII deri më 1912)*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1991, f. 28. Në periudhën osmane në zonat e malësive ekzistonin disa institucione të ndryshme nga qyteti, ku ndër ta ishin bajraktari, alemdari, koçobashi, vojvoda, *alemdari*, që ndryshe është bajraktari, personi i cili mban bajrakun/flamurin. Kurse *koçobashi* kryesonte pleqësinë e një katundi. Ndryshe kishte edhe kuptimin e kryeplakut, kreut, qefalia i katundit.

11 İşkodra Vilayeti Salnamesi 1310/1892, f. 69.

12 Kahreman Ulqini, *po aty*, f. 28.

kajmekami i Shijakut, Velijudini, ndërsa ai i Tuzit emërohet në kazanë e Krujës. (BOA, *DH.MKT. 1842/47*).

- Në vitin 1891, si kajmekam i kësaj kazaje qe emëruar kolonel Halil Beu (BOA, *Ë..DH..1266/99582; İşkodra Vilayeti Salnamesi h.1310/1892, f. 80*).
- Në vitin 1893 u emërua kolonel Salih Efendiu (BOA, *BEO, 417/31215; Ë..DH.. 1363/1316/Za-43; İşkodra Vilayeti Salnamesi h.1312/1894, f. 83*).
- Në vitin 1898, pasi Salih Efendiu emërohet në Selanik, në vend të tij, si zëvendës emërohet kolonel Mustafa Efendiu (BOA, *BEO, 1223/91710; DH.MKT. 2150/7; BEO, 1363/102194*).
- Më pas, në vitin 1905, në këtë post emërohet kolonel Mehmed Efendiu (BOA, *DH.MKT, 993/40; Ë..DH..1441/1323/Z-16*).
- Në vitin 1908, në këtë detyrë emërohet Abdurrezak Efendiu (BOA, *Ë..DH..1464/1326/s-33*).
- Në të njëjtin vit qe emëruar edhe kolonel Ismail Haki Beu (BOA, *DH.MKT. 2697/99*).
- Nuk do të zgjasë shumë dhe pas tij, në vitin 1909 u emërua kapiten Qazim Efendiu (BOA, *Ë..DH..1473/1327/S-35; DH.MKT.2792/95*).
- Dhe në fund, në vitin 1911, në këtë post u emërua përkthyesi zyrtar i vilajetit të Shkodrës, Mihal Efendiu, i cili qëndroi në këtë detyrë deri në fund të Perandorisë Osmane në Tuz. Nga emri i tij, ne kuptojmë që duhet të ketë qenë i krishterë (BOA, *Ë..DH..1488/1329/B-06; BEO, 3915/293573*).

Dokumentacioni arkivor dhe salnamet e vilajetit të Shkodrës (1310/1892 dhe 1312/1894) na tregojnë se Tuzi, nga një fshat që ishte më përpara, u bë qendër dhe mori statusin “kaza” (komunë), ku, për rrjedhojë, do të kemi bashkëngjijtjen e krahinave dhe fshatrave përreth tij. Numri i këtyre fshatrave arrinte në njëzet e katër. Ndër krahinat dhe fshatrat e njohura që kazaja e Tuzit përfshinte, nën administrim kanë qenë: Hoti, Daçiqi (Deçiqi), Gruda, Dinosh, Milesi, Rogami (Rogathi), Dheu i Zi (Kara Topraku), Vladina, Matgushi, Shipshaniku, Vranja, Rapsha, Ksheva, Nerhelmi, Traboini etj. (BOA, *Y.A...RES, 9/28*).

Për popullsinë e Tuzit të shek. XIX ekzistojnë disa të dhëna me të cilat mund të hidhet sadopak dritë. Sipas konsullit francez Hequard, Gruda-Tuzi kishte një popullsi prej rreth tre mijë banorësh, nga të cilët 2/3 ishin

të krishterë, ndërsa 1/3 myslimanë.¹³ Dhjetë vite më pas, sipas relacionit të Ahmet Xhevdet Pashës, krahina e Grudës, që në kuadrin e vet kishte Tuzin, numëronte treqind e pesëdhjetë shtëpi, nga ku njëqind prej tyre i përkisnin besimit islam, dyqind e pesëdhjetë atij latin (katolik) dhe asnjë ortodoks, dhe se të gjitha këto shtëpi ishin me shqiptarë dhe flisnin shqip. Kjo krahinë nxirrte tetëqind pushkë.¹⁴

Sipas salnames së vitit 1310/1892, kur Tuzi i kishte mbushur trembëdhjetë vite nga marrja e statusit të kazasë (komunës), numëronte një mijë e dyqind e dhjetë shtëpi dhe shtatë mijë e dyqind banorë, nga ku dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë prej tyre i përkisnin besimit islam, ndërsa pjesa tjetër atij të krishterë. Ndërsa dy vjet më vonë, po sipas salnames, komuna e Tuzit numëronte rreth një mijë e dyqind e tridhjetë shtëpi, dhe shtatë mijë e pesëqind banorë, nga ku tre mijë e njëqind e tridhjetë prej tyre i përkisnin besimit islam, kurse pjesa tjetër atij të krishterë. Në këtë salname shohim se Gruda si e vetme numëronte treqind e pesëdhjetë shtëpi myslimane dhe dyqind e pesëdhjetë katolike dhe me tre mijë e gjashtëqind banorë, nga ku dy mijë e pesëqind prej tyre ishin myslimanë, një mijë e pesëqind katolikë dhe asnjë ortodoks. Peter Bartl pohon se kazaja e Tuzit në vitin 1900 numëronte dy mijë e pesëqind e njëzet shqiptarë myslimanë, katër mijë e treqind e tetëdhjetë të krishterë dhe gjashtëqind myslimanë sllavishtfolës. Kurse për qendrën e Tuzit pohon se numëronte gjashtëdhjetë shtëpi të banuara nga myslimanë shqiptarë dhe sllavishtfolës dhe se ishte vendi i grumbullimit të myslimanëve të emigruar nga Mali i Zi.¹⁵ Vendosija e muhaxhirëve në Tuz dëshmohej si nga dokumentacioni arkivor osman e po ashtu edhe nga disa gurvarre që kanë të shënuar epitetin “muhaxhir”.¹⁶ Për rrjedhojë, ky fenomen do të rriste edhe numrin e banorëve të komunës dhe qendrës së Tuzit.

Sipas shumë dokumenteve të arkivit dhe salnameve të cekura më sipër, komuna e Tuzit, e cila bënte pjesë në sanxhakun e Shkodrës, kishte ngritur organet e administratës publike lokale duke filluar nga viti 1879, deri në vitin 1912. Organet publike më të rëndësishme të ngritura në këtë komunë kanë qenë: kryetari-kajmekami, që zakonisht vërehen të kenë qenë persona me grada ushtarake, si major (bimbash) apo kolonel, të cilët

13 Hyacinthe Hecquard, *Historia dhe përsbkrimi i Shqipërisë së Epërme ose Gegërisë*, Plejad, Tiranë, 2008, f. 90.

14 Cevdet Paşa, *Tezâkir*, 18-19, f. 191-192.

15 Peter Bartl, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, Dituria, Tiranë, 2006, f. 54.

16 Shih faksimilet në shtojcën nr. VII.

kishin nën kontroll edhe ushtrinë e nizamëve brenda kazasë; kuvendi apo këshilli drejtues i kazasë; gjykata e shkallës së parë (Mahkeme-i Bidayet), që udhëhiqej nga naibi apo gjykatësi i kazasë; drejtoria e financave; sekretari i shkrimeve zyrtare (tahrirat katibi); nëpunësit e pasurive të paluajtshme të kazasë dhe ata të gjendjes civile; zabita apo policia komunale; drejtoria e telegrafit dhe e postës; drejtoria e borxheve të përgjithshme; drejtoria e doganave e kështu me radhë.¹⁷

Kur Tuzi u shndërrua në kaza (komunë) dhe u ngritën shumë organe të administratës publike, të cekura më lart, lindi nevoja edhe për ndërtime të tjera me karakter shoqëror. Sipas salnames së vitit 1310/1892, kazaja e Tuzit numëronte dy xhami¹⁸, katër shkolla (mektebe) dhe katër kisha.¹⁹ Kurse dy vite më pas, sipas salnames, përveç këtyre ndërtimeve, në qendër të Tuzit shohim të ndërtuar një spital dhe një kazermë ushtarake (kışla). Siç u pohua edhe më lart, qendra e Tuzit mbeti në statusin e fshatit deri në vitin 1879 dhe ka pasur të ndërtuar vetëm një xhami (mesxhid) (Xhamia e Vjetëre Nizamëve), si dhe një shkollë (mekteb). Nga një dokument i Arkivit të Stambollit, datë 01 Rebiulahir 1132/ 11 shkurt 1720, shohim

17 Ali Bardhi, "Formimi i Komunës së Tuzit - Organet e Administratës Publike Lokale në Komunën-Kazanë e Tuzit në fund të Periudhës së Shtetit Osman", Koha Javore, Podgoricë, datë 05. 04. 2012 (botuar në tre numra).

18 Nga salnamet e vilajetit të Shkodrës të vitit 1892 dhe 1894 shohim se në kazanë e Tuzit janë të shënuara dy xhami. Njëra prej tyre mendojmë se është Xhamia e Vjetëre Nizamëve, e cila u ndërtua kur Tuzi ishte fshat, kurse për tjetrën nuk mund të pohojmë të ketë qenë e ndërtuar në qendër të Tuzit, pasi xhamia e dytë e cila njihet si Xhamia e Kapedan Qazim Begut, nga pllaka e saj shihet të jetë ndërtuar në vitin 1909/1910. Ndërkohë që në hapësirën e kazasë së Tuzit kemi Xhaminë e Dinoshës, e cila në pllakën e vet ka të shënuar se është ndërtuar në vitin 1770. Po kështu, në hapësirën e kësaj kazaje, nga të dhënat që na ofron studiuesi Bajro Agoviq kemi xhaminë e fshatit Vranje, e ndërtuar në vitin 1830, si dhe xhaminë e fshatit Vllanë, ku si datë ndërtimi jepen dy versione: i pari në vitin 1717, kurse tjetri në vitin 1937. Shih Bajro Agoviq, *Džamije u Crnoj Gori (2001)*, f. 87-88; *Džamije u Crnoj Gori (2012)*, f. 29-30.

19 Në periudhen osmane, në Malësi janë ndërtuar shumë kisha katolike. Ndërtimet e këtyre kishave përgjatë shekujve osmanë janë rezultat i lejeve që pushteti lëshonte ndaj besimeve fetare. Hulumtuesi i historisë kishtare në territorin e Shqipërisë, atë Llovro Mihaçeviq, shkruante në punimin e tij "Po Albaniji-Dojmovi s'puta 1883-1907" se në shekullin XVII françeskanët kishin filluar të vijnë në numër të madh në tokat shqiptare. Ata themeluan famullinë françeskane në Traboin, në vitin 1648, dhe vazhduan këtë mision në 9 fshatra të tjera të Malësisë së Madhe. Edhe studiuesi i njohur Robert Elsie, në librin "Fiset shqiptare" pohon se "kisha më e vjetër e rajonit është ajo e Priftënit, e njohur si Kisha e Grudës, e ndërtuar, së pari, në vitin 1528... Kisha e Shën Martinit është ndërtuar nga françeskanët në vitin 1646, megjithë kalimin e shpejtë të popullatës në fenë islame, por u braktis pas ca kohë... Në Hot kemi kishën e famullisë së Brigjës, e ndërtuar në vitin 1699 nga françeskanët... Në Traboin ka qenë një famull katolike që nga viti 1648, megjithëse shpesh braktisej", f. 43, 46, 70-71, 79, 86. Kurse kisha katolike në fushën e Tuzit – Vuksanlekaj, për të cilën do të flasim në vijim, nga dokumentacioni arkivor shohim se në vitin 1902 kërkohet dhe i jepet leja e ndërtimit.

vendimin e kadiut të Podgoricës dhe karaxhadakut, Ali Efendiut, për ndërtimin e një xhamie në fshatin Tuz, që vjen si nevojë e banorëve. Po kështu, në dokument ceket se donatori i ndërtimit të kësaj xhamie ishte Mehmed Aga, banor i Kalasë së Shpuzës. Vendimi i kadiut përfshin faljen e namazeve të xhumasë, bajrameve dhe lejen për ligjëratë (vaz).²⁰

Edhe inspektori i arsimit të vilajetit të Shkodrës, Davud Boriçi, në ditarin e tij të punës, të shkruar në osmanisht, e përmend xhaminë dhe shkollën fillore në fshatin Tuz. Njëherësh, këto dy detyra i mbulonte molla Bajram Pejani. Në një shkresë të datës 27 korrik 1286 (rumi) / 08 gusht 1870 shohim një ankesë të bërë për imamin në fjalë nga bajraktari i Tuzit, vojvoda dhe paria e Tuzit dhe e xhamisë, nën drejtimin e inspektorit të arsimit dhe vilajetit të Shkodrës, ku kërkohej që imami në fjalë të shkarkohej, me pretekstin se nuk ishte i përshtatshëm dhe se banorët nuk ndiheshin të sigurt me të. Personat që kanë nëshkruar në këtë shkresë janë: Bajram Koçi (Kuçi), Jusuf Elezi, Ahmed Rama, Abdyl Haxhi (Axhi), Bajram Sula, (vojvoda), bajraktari i Tuzit (Tafil Kurti), Haxhi Shaba, Abdyl Rama, Rexh Mui (Muji) dhe Ali Rama.²¹ Nuk dihet se si ka vijuar më tej fati i imamit, por nga gurvarri nr. 40, shohim të varrosur në anën e poshtme të xhamisë, në drejtim të mihrabit, imamin e Tuzit, molla Bajram Begun (1876).

Në një dokument të vitit 1309/1889, të gjetur në Arkivin Osman të Presidencës-Stamboll, shohim vendimin për restaurimin e xhamisë (mesxhidit) së mëparshme, të vetmen në qendër të Tuzit, zgjerimin e saj dhe ndërtimin e një minareje prej druri që do të shërbente për nevojat e myslimanëve të qendrës së Tuzit dhe ushtarëve (nizamëve) osmanë. (BOA, *I.DH.*, 1265/99437). Po kështu, nga një dokument tjetër i datës 29 muharrem 1312/ 22 korrik 1895, që bën fjalë për zhvendosjen e shkollës nga kjo xhami në një vend tjetër brenda Tuzit, bëhet fjalë për të njëjtat punime në xhami, si zgjerimi i saj dhe ndërtimi i një minareje prej druri dhe se do t'u shërbente myslimanëve të Tuzit dhe ushtarëve osmanë që jetonin në kala. Në dokument ceket edhe ekzistenca e varrezës (kabristanit) në të katër anët e xhamisë (BOA, *MFMKI*, 274/61). Minaren prej druri dhe varrezën për të cilën bëhet fjalë në këto dokumente, e shohim edhe nga një fotografi e publikuar e Xhamisë së Nizamëve. Ndërsa për xhaminë tjetër në qendër të Tuzit, e cila njihet si Xhamia e Qazim Begut, edhe pse shumë vite më përpara ka qenë marrë vendimi për ndërtimin e saj, fakt të cilin e shohim nga tri dokumente arkivi, vëmë re se ajo nuk u ndërtua deri vonë. Në dokumentin e parë, të datës 8 mars 1879, shohim një shkresë

20 BOA, *AE.SAMD.III*, 9/825. Shih faksimilen në shtojcën nr. II-a, II-a1.

21 Ali Bardhi, *Müfettiş Davut Boriçi'nin Günlüğünde İşkodra Vilayeti'nde Eğitim 1870-1877*, f. 182.

të dërguar nga vilajeti i Shkodrës në drejtim të kryeministrisë osmane, kurse pas dy muajsh, më 4 maj 1879, shohim të punuar skicë-planin e xhamisë (BOA, *ŞD*, 1956.A / 21 – 7; BOA, *ŞD*, 1956-A/21). Po kështu, pas disa vitesh, edhe nga një dokument tjetër i datës 29 korrik 1892, shohim vendimin për ndërtimin e saj (I.M.F., 1/1310/M-3). Realizimin e kësaj ëndrre pas disa vitesh do të mund ta adresojë kajmekami i njohur, manastirliu kapedan, Qazim Dirik Begu, fakt të cilin e shohim edhe në pllakën origjinale të xhamisë së ndërtuar në vitin 1327 h/1909-1910. Në pllakë shkruhetse kjo xhami është hapur nga kajmekami i Tuzit, Qazim Begu, në periudhën e sulltan Mehmedit V Reshadit dhe me arkitekt haxhi Dervish Dibrës. Sulltan Mehmed Reshadi, në qershorin e vitit 1911, njihet për vizitën e tij madhështore në Rumeli, gjegjësisht në Selanik, Manastir e Kosovë, ku u prit nga mijëra shqiptarë e të tjerë. Për këtë vizitë akoma ruhen si dëshmi dokumente arkivore dhe fotografi. Kajmekami kapedan (yüzbaşı) Qazim Begu ishte nga Manastiri, biri i një kapedani që kishte marrë pjesë në luftën e Plevnes. Në vitin 1904, Qazim Begu, me të përfunduar akademinë ushtarake në Manastir, u emërua kapedan (yüzbaşı) në Shkodër, ku qëndroi deri në vitin 1908. Në Shkodër u martua me vajzën e komandantit të kalasë së Shkodrës, kolonel (miralaj) Fahri Begut. Një vit më pas, pasi u emërua si kajmekam i Tuzit, brenda një viti arrin që të ndërtojë xhaminë (1909/1910) dhe shkollën. Vdiq në vitin 1941, në Edirne.²²

Vlen të përmendet se në vitin 1902 kemi edhe ndërtimin e një kishe katolike për besimtarët që jetonin në fushën e Tuzit, gjegjësisht në Vuksanlekaj. Nga dokumentacioni arkivor osman shohim se ndërtimi i kësaj kishe vjen si rezultat i nevojës që kishin dyzet e dy (42) shtëpitë katolike me rreth dyqind-treqind (200-300) banorë, që jetonin në fushën e Tuzit, gjegjësisht në hapësirën ndërmjet qendrës së Tuzit dhe Nerhelmit, Vranjes, Burgas dhe mëhallës së Hakshabanajve, të cilët më përpara shërbesat fetare i kryenin në Kishën e Traboinit. Nga dokumentacioni, shohim se autoriteteve osmane u kërkohet leja për shndërrimin e një shtëpie virane në kishë katolike, si dhe dhënien e lejeqëndrimit të priftit në Vuksanlekaj-Tuz. Disa ditë më pas, shohim vendimin e qeverisë osmane për lejimin e shndërrimit të shtëpisë në kishë, si dhe dhënien e lejeqëndrimit të priftit. Dhuruesi i shtëpisë dhe i parcelës shënohet të ketë qenë Prenta, vajza e Maça (Maca) Mixhës, banore e bajrakut të Traboinit. Shpenzimet për ndërtimin e kishës dhe shtëpisë së priftit janë parashikuar të ishin

22 BOA, *İ..DH.* 1473/1327/S-35; *DH.MKT.*2792/95; Ajdin Rakić, *Ćazim Beg – Od Velikog Komandanta do kulturnog reformatora*. www.monteislam.com, 06.05.2020.

katër mijë e treqind e njëzet kurush dhe janë siguruar nga Arqipeshkvia e Shkodrës (BOA, *HR.ËD.*, 2043/18; *BEO*, 1932/144858).

Siç u përmend më përpara, në vitin 1892, hapësira që ka përfshirë kazaja e Tuzit ka pasur katër shkolla. Mbetet e paqartë për ne se kur kanë filluar shkollat e para në këtë kaza! Mirëpo, nga reforma arsimore e vitit 1869, shohim ndërtimin e shumë shkollave me sistem të ri në Perandorinë Osmane, ku bënte pjesë edhe vilajeti i Shkodrës me kazanë e vet Tuzin, fakt që e ndeshim edhe në ditarin e inspektorit të arsimit të këtij vilajeti, myderrizit Davud efendi Boriçi. Nga të dhënat që na jep ai shohim se në vitin 1870, në fshatin e Tuzit ka qenë e hapur një shkollë fillore. Mësues i saj ka qenë Molla Bajrami, i cili ishte njëherazi edhe imam i xhamisë së Tuzit. Po kështu, në ditarin e Boriçit shohim të shënuar kërkesën e Mustafa efendi Podgoriçanit, të birit të Halil Haxhi Hasanajt, për t'u punësuar në këtë shkollë. Paga e mësuesit të kësaj shkolle jepej nga Drejtoria e Financave të kazasë së Podgoricës. Nga dokumenti i dytë arkivor, që kemi cekur kur kemi bërë fjalë për Xhaminë e Nizamëve, shohim se shkolla e cila ndodhej pranë saj, u zhvendos në një vend tjetër në Tuz, si shkak i zgjerimit të xhamisë dhe ndërtimit të minares së drurit, duke e dëmtuar hapësirën e shkollës. Njëherazi, prania e varreve në të katër anët e xhamisë dhe pamundësia për të ndërtuar shkollën, bëri që ajo të zhvendoset në një vend tjetër në qendër të Tuzit.

Nga shënimet e Müfid Pashës, të birit të Shemsi Pashës, shohim se në vitin 1907, në afërsi të Tuzit, pranë një kazermë tjetër ushtarake osmane, ka qenë e ndërtuar edhe një urë, e cila njihej si Ura e Haxhi Tahirit. Po kështu, edhe nga një dokument arkivi shohim të ketë qenë edhe një kazermë me emrin e Haxhi Tahirit.²³ Emërtimi i njëjtë i urës dhe kazermës, na shtyn të supozojmë se edhe toponimi duhet të jetë quajtur si Haxhi Tahiri. Nuk kemi të dhëna se kur është ndërtuar dhe ku ndodhej kjo urë, porse në të ardhmen nevojiten që të bëhen hulumtime për të.

Përpos ndërtimeve të shumta publike që u ngritën brenda tri dekadave, vlen që të përmenden edhe ndërtimet për sigurinë e mbrojtjes së komunës së Tuzit. Gjatë këtij intervali kohor, kemi ndërtimin e kalasë për ushtarë në Shipçanik, si edhe ndërtimin e disa fortifikatave dhe postave ushtarake në Tuz, Selishtë, Dinoshë, Rogath, Vranë, Nënhelm, Vllanë, Deçiç, për të cilat nevojiten studime në të ardhmen. Që nga momenti kur Tuzi u bë komunë (kaza) nuk gjeti qetësinë e duhur, si rezultat i sulmeve të ndryshme dhe ngjarjeve që do të pasonin deri në aneksimin e tij prej Malit të Zi.

23 BOA, *DH.MKT*, 1129/43; Müid Şmsi, *Şmsi Paşa, Arnavudluk ve İttihad-Terakki*, Haz. A. Nezih Galitekin, Istanbul, 1995, f. 29.